



Përshkrimi i shkurtër i projektit

Qëllimi: Fuqizimi dhe përmirësimi i kapaciteteve administrative për harmonizimin dhe zbatimin e legjislativit të BE-së për mbrojtjen e natyrës.

Qëllimet afatgjate: Fuqizimi dhe përmirësimi i kapaciteteve administrative të Ministrisë për mjedisin jetësorë dhe për planifikim të hapësirë / Drejtorisë për mjedisin jetësorë për zbatimin e legjislativit të BE-së për mbrojtjen e natyrës përmes përpilimit të rregullativës ligjore, sigurimin e trajnimeve dhe përmes zbatimit të legjislativit të BE-së për mbrojtjen e natyrës siç janë Direktivat për shpendët dhe habitatet dhe Rregullativa e Këshillit (BE) nr. 338/97 për mbrojtjen e llojeve të florës dhe faunës së egër.

Shfrytëzuesi: Ministria për mjedisin jetësorë dhe për planifikim hapësinorë (MMJPH).

Palët e përfshira relevante për “**Natura 2000**”: Ministria për bujqësi, pylltari dhe ekonomi të ujërave, Ndërmarrja publike për ekonomizim me kullosat dhe Ndërmarrja për pyjet kombëtare, parqet kombëtare dhe territoret tjera të mbrojtura, OJQ, inspektoratet shtetërore për mjedisin jetësorë, pylltarinë dhe gjuetinë, bashkësia akademike, pronarët dhe shfrytëzuesit e tokave, sektori i turizmit, sektori për gjueti dhe peshkatarin, në bashkëpunim me Delegacionin e BE-së në Maqedoninë e Veriut.

Palët e përfshira relevante për **CITES**: Agjencia për ushqim dhe veterinë, Drejtoria fito-sanitare, Drejtoria doganore, policia kufitare, inspektoratet shtetërore, bashkësia akademike, në bashkëpunim me Delegacionin e BE-së në Maqedoninë e Veriut dhe të tjerë.

Konzorciumi për realizim: NIRAS IC (udhëheqës) me partnerët: Shoqata ekologjike maqedonase (SHEM), FARMAHEM Shpkthp, organizata „Stiching Birdlife Europe“, Shoqata polake për mbrojtjen e shpendëve, EFTAS hulumtime prej së largu dhe transferimi i teknologjive (EFTAS Remote Sensing and Transfer of Technologies).

Maqedonia e Veriut bën përgatitjet për zbatimin e direktivave të BE-së për mbrojtjen e natyrës (Direktiva për habitatet dhe Direktiva për shpendët) si dhe zbatimin e

Qëllimet kryesore të projektit:

1. Komponenti për “Natura 2000”:
 - i. Vlerësimi dhe përpilimi i draftit të formularëve standarde për të dhënat në lidhje me territoret potenciale për “Natura 2000” në mbarë shtetin.
 - ii. Ndërtimi i kapaciteteve dhe i programit për ngritjen e vetëdijes publike për realizimin e rrjetit “Natura 2000”.
2. Komponenti për CITES:
 - i. Përpilimi i legjislativit primarë të harmonizuar me CITES – Rregullativa e Këshillit (BE) nr. 338/97, duke përfshirë edhe zhvillimin e softuerit përkatës.
 - ii. Ndërtimi i kapaciteteve dhe i programit për ngritjen e vetëdijes publike për rregullativën CITES.

Pjesa kryesore e komponentit për “Natura 2000” është puna në terren në mbarë shtetin me qëllim të vlerësimit të më shumë se 20 vendeve potenciale. Puna në terren do të përkrahet me të dhënat e fituara nga hulumtimi prej së largu dhe nga SIGJ softueri i veçantë i bazuar nga ueb-i për menaxhim përkatës me të dhënat për habitatet dhe llojet. Do të organizohen trajnime dhe punëtori për fuqizimin e kapaciteteve administrative. Përsikaj kësaj, do të sigurohet edhe programi për informim të opinionit për “Natura 2000”.

Qëllimi i komponentit për CITES është arritja e harmonizimit të tërësishëm i legjislativit vendor dhe Rregullativën dhe konventën CITES të BE-së për tregti ndërkombëtare me llojet e rrezikuara të florës dhe faunës së egër.

Një gjë e tillë do të realizohet përmes verifikimit të harmonizimit të akteve ekzistuese juridike me të cilët rregullohet mbrojtja e natyrës si dhe përmes përpilimit të legjislativit të ri / të reviduar. Do të programohet edhe softueri i veçantë për dhënie e lejes për tregti.



<p>Rregullativës CITES për tregti ndërkombëtare me llojet e rrezikuara të florës dhe faunës së egër. Për rezultatet e projekteve do të diskutohet me palët e përfshira që të sigurohet implementimi i suksesshëm.</p>	<p>Në bazë të analizës së kapaciteteve ekzistuese dhe përmes integritit të praktikave më të mira të BE-së, projekti do të përfshijë masat për ndërtim të kapaciteteve përmes programit për trajnime.</p>
<p>Kontakti: Vllatko Tërpeski (MMJPH/Shfrytëzues): v.trpeski@moepp.gov.mk Daniell Bogner (lider i ekipit): boda@niras.com Zyra projektuese ICNC.project@niras.dk</p>	<p>Kohëzgjatja: 1qershor viti 2022 – 1 dhjetor viti 2024 (30 muaj)</p>